

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par.1 të KPK-së., dhe L.S. nga Gjilani për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale – lëndim trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 25 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.148/2017 datë 29.11.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 20.02.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, detyrimisht ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, PKR.nr.148/2017 datë 29.11.2017, ashtu që ndaj të akuzuarit F.S. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par.1 të KPK-së., dhe L.S. nga Gjilani për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale – lëndim trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 25 të KPK-së, refuzohet akuza konform dispozitës së nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) lidhur me nenin 91 par.6 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

III. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan.

A r s y e t i m i

Me aktakuzën e Prokurorisë së Qarkut në Gjilan, PP.nr.55/12 dt. 01.03.2012, të pandehurit F.S. për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së dhe L.S. për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale – Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 25 të KPK-së. Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me aktgjykimin PKR.nr.148/2017 datë 29.11.2017, të akuzuarin F.S. e ka shpallur fajtorë për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par.1 të KPK-së, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 28.02.2012 deri me datën 06.07.2012, ashtu që mbeten për ti vuajtur edhe 51 (pesëdhjetenjë) ditë burgu, i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit i

shndërrohet në dënim me gjobë në shumë 600 (gjashtëqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë. Të akuzuarin L.S. e ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale – lëndim trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 e lishur me nenin 25 të KPK-së, për çka e ka gjykuar me dënim burgu në kohë zgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh i cili dënim me kërkesën e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë. Detyrohen të akuzuarit që kësaj gjykate t'ia paguajnë shumat paushallë prej 50 euro, për secilin veç e veç, ndërsa shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, lëndën ta kthej në rivendosje njëkohësisht sa i përket sanksionit penal ndaj tyre të shqiptohet një dënim më i rëndë-ashpër.

-Përgjigje në ankesën e PTH ka bërë mbrojtësi i të akuzuarit F.S., av. S.M. i cili ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar dhe aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.28/2018 të dt. 19.01.2018 ka propozuar që ankesa e Prokurorisë të aprovohet si e bazuar ndërsa përgjigja e mbrojtësit të akuzuarit F.S., av. S.M. të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe ankesa e prokurorisë është e pa bazuara.

Prokurori në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 të KPP pasi që dispozitivi i aktgjykimin është i pa kuptueshëm dhe kundërthënës me gjendjen faktike apo me faktet vendimtare. Gjykata ka bërë gabimisht zbatimin e dispozitave të Kodit Penal të Kosovës që ndërlidhen me dispozitën e nenit 385 të KPRK si dhe provat të cilat janë të grumbulluara e njëkohësisht interpretimi nga ana e trupit gjykues nuk ka qenë i mjaftueshëm kur të akuzuarit nuk i shpalli fajtorë për veprat penale për të cilat janë akuzuar. Sipas prokurorisë gjendja faktike është vërtetuar gabimisht nga se elementet përcjellëse të veprës penale janë paraparë me nenin që ka të bëjë me veprën penale Vrasje në tentativë dhe ndihmë në kryerjen e vrasjes në tentativë e që në mënyrë të qartë janë provuar me fakte dhe prova konkrete, siç janë deklaratat e të akuzuarve, të dëmtuarit A.K. dhe dëshmitarëve P.S., M.M. dhe N.S. mirëpo përkundër këtyre gjykata ka vërtetuar

se nuk kanë qenë të mjaftueshme të vërtetohen tiparet e veprës penale për të cilën ata janë akuzuar nga prokuroria.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret, gjykata ka dhënë arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, ka dhënë arsye për faktet vendimtare si dhe ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar edhe gjendjen faktike kur ka bërë rikualifikimin e veprës penale dhe atë për të akuzuarin F. nga Vrasja në tentativë në veprën penale Lëndim i lehtë trupor ndërsa për të akuzuarin L. nga Ndihma në vrasje në tentativë në veprën penale të Ndihmës në lëndim trupor, pasi që nga provat e administruara u vërtetua se i akuzuari është e vërtetë se e ka goditur të dëmtuarin A. por se nuk ka mundur të vërtetohet se a ka qenë shufër metalike apo e drurit siç thekson i akuzuari F. por ajo çka është më me rëndësi është se është vërtetuar se i akuzuari të dëmtuarin e ka qëlluar vetëm njëherë e që tregon se i njëjti nuk e ka pasur qëllimin që ta privoj nga jeta të dëmtuarin por siç ka theksuar gjykata e shkallës së parë vetëm për t'iu hakmarrë për shkak të zënkës së të dëmtuarit me babain e të akuzuarit F. dhe se gjatë kësaj goditje ka pësuar lëndim të lehtë trupor.

Pra pretendimet e Prokurorit se në veprimet e të akuzuarve gjenden elementet e veprave penale Vrasje në tentativë dhe Ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasjes në tentativë janë të pa bazuara. Mirëpo duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me ligjin penal, kjo gjykatë vlerëson se për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtorë të akuzuarit F.S. dhe L.S. ka arritur parashkrimi absolut për çka edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kështu, nga aktgjykimi i kundërshtuar del se i akuzuari F.S. është shpallur fajtor për veprën Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 lidhur me par.1 të KPK-së, ndërsa i akuzuari L.S. për shkak të veprës penale Ndihmë në kryerjen e veprës penale – lëndim trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 e lishur me nenin 25 të KPK-së, për të cilën parashihet dënimi me burgim deri në 3 vjet, kurse vepra penale rezulton të jenë kryer me 10.02.2012. Sipas dispozitës së nenit 90 par. 1 pika 5 të KPK i cili ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe gjatë zbatimit të procedurës penale në shkallë të parë, për veprat penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre vjet nga kryerja e veprës penale, ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK, ndjekja penale ndalohet me çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Duke pas parasysh se afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, rezulton se që nga koha e kryerjes së veprave penale (10.02.2012) e deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj Gjykate kanë kaluar mbi 6 vite, çka do të thotë se në rastin konkret ndaj të akuzuarve për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor ka arritur parashkrimi absolut i ndjekës penale.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.20/18, më 20.02.2018

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Have Haliti _____